



Informacion për Mbajtësit e Vizave të Përkohshme në Australi

Atual me datën 4 Prill 2020

Qeveria Australiane ka njoftuar ndryshime në marrëveshjet e përmbajtësit të vizave të përkohshme. Këto ndryshime kanë për qëllim të mbrojnë shëndetin e komunitetit tonë, të ruajnë rastet për punësim të Australianëve, të mbështesin industritë që janë kritike, dhe të ndihmojnë me rikuperimin e shpejtë pas virusit.

Mbajtësit e vizave në Australi duhet të ndjekin këshillat e shëndetit publik në lidhje me COVID-19.

Punëtorët që Punojnë duke qenë me Pushime (Working Holiday Makers)

Ndryshimet në vizat e punëtorëve që punojnë duke qenë me pushime, mbështesin sektorët kritikë të shëndetit, kujdesit për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, bujqësinë dhe përpunimin e ushqimit dhe kujdesin për fëmijët.

- Nëse jeni punonjës që punon duke qenë me pushime, dhe punoni në një prej këtyre sektorëve kritikë, përjashtohen nga kufizimi i punës 6 muajsh me një punëdhënës dhe gjithashtu do të jenë të ligjshëm për një vizë të mëtejshme për të vazhduar punën në këta sektore nëse viza juaj e tanishme do të skadojë në 6 muajt e ardhshëm.

Në se keni një vizë me të drejtë pune gjatë pushimeve, dhe nuk jeni në gjendje të suportoni vehten, duhet të niseni për në shtëpi.

Punëtorët Sezonal

Programi për Punëtorët Sezonal si dhe punëtorët e Skemës për Vendet e Paqësorit do të jenë në gjendje të zgjasin qëndrimin në Australi për të mbështetur sektorin bujqësor.

Nëse jeni në Australi dhe merrni pjesë në Programin e Punëtorëve Sezonal do të jeni në gjendje të aplikoni për një vizë të Aktivitetit të Përkohshëm (nënklasa 408) në rrjedhën e Ngjarjes së Miratuar nga Qeveria Australiane (Australian Government Endorsed Event -AGEE). Punëtorët e Skemës së Punës së rajonit të Paqësorit janë në gjendje të bëjnë kërkesa për një vizë të re të Punës së Përkohshme (Marrëdhënjet Ndërkombëtare) (nënklasa 403) e Skemës së Punës për zonën e Paqësorit.

Mbajtësit e Vizave të Vizitorëve

Nëse ndodhesh në Australi me një vizë për vizitorë dhe nuk jeni në gjendje të suportoni vehten, duhet të ktheheni në shtëpi në se është mundësia.

Studentët Ndërkombëtarë

Studentët ndërkombëtarë inkurajohen të mbështeten tek ndihma nga familjet, punë me kohë të reduktuar kur ka mundësi dhe kursimet e tyre për të mbajtur vehten në Australi. Në disa rrethana studentëve do t'ju jepet mundësia të përdorin kursimet e fondit "superannuation."

Qeveria gjithashtu do të jetë fleksibël në lidhje me kushtet e vizave studentore për të marrë parasysh Coronavirusin në rastet që kushti është i përbushur.

Mbajtësit e Vizave të Përkohshme për Persona të Aftë

Nëse keni një vizë të Përkohshme për Aftësi në punët ku ka mungesa (Temporary Skill Shortage) dhe ju kanë pushuar nga puna por jo hequr fare, ju do të mbani vlefshmërinë e vizës dhe bizneset do të kenë mundësinë të zgjasin vizën tuaj sipas rregullimeve normale. Qeveria gjithashtu do t'ju lejojë të nxirrni deri \$10,000 nga fondi superannuation që keni për të ndihmuar vehten tuaj.

Bizneset gjithashtu do të jenë të gjendje të zvogëlojnë orët tuaja të punës. Në këtë rast as ju dhe as punëdhënësi juaj nuk do t'i keni shkelur kushtet ose detyrimet e vizave.

Nëse jeni larguar nga puna ose jeni i papunë, do t'ju duhet të gjeni një punëdhënës tjetër brenda 60 ditëve ose të bëni marrëveshje për t'u larguar nga Australia, kur është e mundur.

Informacione të tjera rreth këtyre rregullimeve të përkohshme gjenden në faqen e internetit të Departamentit: <https://covid19.homeaffairs.gov.au/>